

Procesverbal nga mbledhja e Bordit të ZRRE-së të mbajtur me 31.07.06 në ora 18:00

Rendi i ditës:

1. Gjendja aktuale e furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve në territorin e Kosovës
2. Detyrat dhe përgjegjësit e Rregullatorit ndaj situatës së vështirësuar të furnizimit me energji elektrike
3. Shqyrtimi i pëlqimit të dhënë KEK-ut për eksport të energji elektrike të datës 05.06.2006 për muajt korrik dhe gusht

Prezent janë:

1. Merita Kostari, kryen detyrën e kryesuesit të Bordit të ZRRE, në mungesë të Nick Frydas kryetar i Bordit (i cili ndodhet në pushim vjetor)
2. Naim Bejtullahu, anëtar bordi
3. Nysret Avdiu, anëtar bordi

Dy anëtarët e tjerë të bordit: Nick Frydas dhe Theranda Beqiri, janë konsultuar nëpërmjet telefonit (dëshmitar 3 anëtarët e Bordit të ZRRE-së).

1. Kryesuesja e Bordit, Merita Kostari prezantoi gjendjen aktuale të furnizimit me energji elektrike të konsumatorëve në territorin e Kosovës, informacionin zyrtar të KEK-ut për gjendjen e vështirësuar me furnizim me energji elektrike si pasojë e rënies së njërive prodhuese B1 (rrjedhjes së kazanit), si dhe obligimet kontraktuale ndaj eksportit.

Anëtarët e Bordit shprehën brengosje dhe kuptojnë reagimet e arsyeshme të konsumatorëve për reduktimet e gjata me energji elektrike.

2. Bordi i ZRRE-së në bazë të ingerencave të dhëna me ligj duhet të marrë masa urgjente në lidhje me obligimet kontraktuale të KEK-ut ndaj eksportit.
3. Bordi i ZRRE, duke u mbështetur në Ligjin e Energjisë Elektrike dhe duke pasur parasysh pëlqimin e dhënë KEK-ut për eksport të energjisë elektrike, të datës 05.06.2006 për muajt korrik dhe gusht 2006 bjen këtë vendim:

Tërhiqet pëlqimi, i dhënë KEK-ut, për eksport të energjisë elektrike të datës 05.06.2006 mbasi nuk janë plotësuar kushtet: 2a dhe 2g të këtij pëlqimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, datë 31.07.2006.

KEK-u është i obliguar që cdo kërkesë të re në lidhje me vazhdimin e kontratës, e nëse janë plotësuar kushtet e dhëna me pëlqimin e datës 05.06.2006 të përmendura më lart për eksport, sërisht t'ia paraqesë kërkesën zyrtare ZRRE-së për dhënie pëlqimi.

Votimi:

Për këtë vendim ishin:

1. Merita Kostari, kryen detyrën e kryesuesit të Bordit të ZRRE, në mungesë të Nick Frydas kryetar i Bordit (i cili ndodhet në pushim vjetor) – për

2. Naim Bejtullahu, anëtar bordi, për

3. Nysret Avdiu, anëtar bordi, për

4. Nick Frydas, për (pëlqimi i dhënë nëpërmjet telefonit, në prezencë të tre anëtarëve të bordit)
5. Theranda Beqiri, për (pëlqimi i dhënë nëpërmjet telefonit, në prezencë të tre anëtarëve të bordit)

Prishtinë 31.07.2006

Ora 18.40